

**Drejtoria Rajonale Tiranë**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tirane, me / / 2021

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Data: 11.05.2021**

**Për Operatorin Ekonomik:** Shoqëria “HTT High Tech Tests ” sh.p.k me adrese selie Njesia Nr.5, Rruga Perlat Rexhepi, Pallati Nr.6, kati 11, Kodi Postar 1019, Tirane, me NIPT L41419011B.

Procedura e prokurimit: Procedure Kerkese per propozim me mjete elektronike / mallra.

Numri i referencës së procedurës: REF-91918-03-30-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje vula plastike për vulosjen e matësave elektrike.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 30 (tridhjetë) dite nga nënshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Cmimi më i ulët **X**; Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Njoftojme se kanë qenë pjesëmarrës në kete procedure si ofertues operatorët ekonomike me vlera te ofruara si me poshte:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “VUHO 2018” sh.p.k me NIPT L72129028, me vlere te ofertes 5,836,000 (pese milion e teteqind e tridhjetë e gjashtë mijë) leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “LIGUS” sh.p.k me NIPT L51523001S, me vlere te ofertes 5,984,000 (pese milion e nenteqind e tetëdhjetë e kater mijë) leke pa TVSH.

## Drejtoria Rajonale Tiranë

3. Operatori Ekonomik Shoqëria “AA&P” sh.p.k me NIPT L61713009Q, me vlerë të ofertës 6,157,000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) leke pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik Shoqëria “HTT High Tech Tests” sh.p.k, me NIPT L41419011B me vlerë të ofertës 1,000,000 (një milion) leke pa TVSH.

I. Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqëria “HTT High Tech Tests” sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky operator ekonomik plotëson Kriteret e Përgjithshmet e Pranimit / Kualifikimit. Ky operator ekonomik dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit. Gjithashtu ky operator plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik përkatës VKM Nr.914 datë 29.12.2014 të ndryshuar dhe Ligjit “Për Prokurimin Publik”.

Gjithashtu, nëni 66 paragrafi 3 dhe 5 i VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” parashikon:

- ✓ “...Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.
- ✓ Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Si dhe nëni 56 i Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikon: “Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- ✓ anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- ✓ zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- ✓ origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ✓ zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi”;

## **Drejtoria Rajonale Tiranë**

Ne keto kushte, duke patur parasysh faktin se kjo procedure eshte publikuar ne zbatim te Ligjit Nr.9643 dt. 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, Komisioni i Vleresimit te Ofertave i kerkoi sqarime ofertuesit Shoqeria “HTT High Tech Tests ”sh.p.k, i cili me shkrese kthim pergjigje drejtuar autoritetit kontraktor me Nr.1035/7 Prot date 23.04.2021 ka argumentuar dhe dokumentuar te gjitha shpjegimet qe justifikojne cmimin e ofruar .

Referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji”*, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor ka vendosur te pranoje dhe te kualifikoje si oferte te vlefshme oferten e Operatorit Ekonomik Shoqeria “HTT High Tech Tests ”sh.p.k.

Ne perfundim, ky komision e vleresoi si te vlefshme dhe te bazuar ne ligj oferten e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqeria “HTT High Tech Tests” sh.p.k.

**II.** Ne lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqeria “LIGUS” sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur, konkludon se ky operator ekonomik ploteson Kriteret e Pergjithshmet e Pranimit / Kualifikimit. Ky operator ekonomik dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka te rregullt konform kerkesave te Dokumentave Standarte te Tenderit. Gjithashtu ky operator ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit ne zbatim te Legjislacionit te Prokurimit Publik perkatesisht VKM Nr.914 date 29.12.2014 te ndryshuar dhe Ligjit “Per Prokurimin Publik”. Referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji”*, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane AK-se ka vendosur te pranoje dhe te kualifikoje si oferte te vlefshme oferten e Operatorit Ekonomik Shoqeria “LIGUS ”sh.p.k.

**III.** Ne lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqeria “VUHO 2018” sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur, konkludon se ky operator ekonomik ploteson Kriteret e Pergjithshme te Pranimit / Kualifikimit. Ky operator ekonomik dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka te rregullt konform kerkesave te Dokumentave Standarte te Tenderit. Gjithashtu ky operator ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit ne zbatim te Legjislacionit te Prokurimit Publik perkatesisht VKM Nr.914 date 29.12.2014 te ndryshuar dhe Ligjit “Per Prokurimin Publik”. Referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne*

## Drejtoria Rajonale Tiranë

*dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji”, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane AK-se ka vendosur te pranoje dhe te kualifikoje si oferte te vlefshme oferten e Operatorit Ekonomik Shoqeria “VUHO 2018 ”sh.p.k.*

**IV.** Ne lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqeria “AA&P” sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor ka vleresuar se nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas DST-se se publikuar nga AK. Konkretisht ky operator ekonomik nuk ka permbushur kriteret e vecanta duke mos plotesuar kerkesat e parashikuara ne Kreun 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar germa ”a” ku eshte kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit 2018, 2019,2020 te konfirmuara me vule prane administrates tatimore. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2020.

**Per keto arsye:** Referuar Krieteve te DST-se te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ku eshte percaktuar shprehimisht se: *“Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim”*; si dhe referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji;*

Oferta e Operatorit Ekonomik te mesiperm eshte refuzuar / s`kualifikuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor.

### **Operatore ekonomike te s`kualifikuar:**

Operatori Ekonomik Shoqeria “AA&P” sh.p.k me vlere te ofertes 6,157,000 (gjashte milion e njeqind e pesedhete e shtate mije) leke pa TVSH.

### **Autoriteti Kontraktor konkludoi:**

Referuar nenit 55 pikes 1 germa a dhe pika 5 e LPP-se ku percaktohet se: *Oferta fituese duhet te jete: Oferta qe ne baze te kerkesave dhe krieteve te percaktuara ne dokumentet e tenderit ploteson kerkesat e objektit te prokurimit me cmimin me te ulet; Pika 5 Autoriteti Kontraktor percakton oferten me te mire pas krahasimit dhe vleresimit te ofertave.*

Ne keto kushte, renditja perfundimtare e operatoreve ekonomike te kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor eshte:

### **Drejtoria Rajonale Tiranë**

1. Operatori Ekonomik Shoqeria “HTT High Tech Tests” sh.p.k me vlere te ofertes 1,000,000 (nje milion) leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik Shoqeria “VUHO 2018” sh.p.k me vlere te ofertes 5,836,000 (pese milion e teteqind e tridhjte e gjashte mije) leke pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik Shoqeria “LIGUS” sh.p.k me vlere te ofertes 5,984,000 (pese milion e nenteqind e tetedhjte e kater mije) leke pa TVSH.

Në përfundim te vleresimit, referuar cmimit me te ulet, fitues i procedurës se prokurimit me objekt Blerje vula plastike për vulosjen e matësave elektrike me fond limit 7,996,000 ( shtate milion e nenteqind e nentedhjte gjashte mije) leke pa TVSH, shpallet Operatori Ekonomik Shoqeria “HTT High Tech Tests ” sh.p.k.

\* \* \*

Duke iu referuar procedures së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik Shoqeria “HTT High Tech Tests” sh.p.k, me adrese selie ne Njesia Nr.5, Rruga Perlat Rexhepi, Pallati Nr.6, kati 11, Kodi postar 1019,Tirane me NIPT L41419011B, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 1,000,000 (nje milion) leke pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë Drejtorise Rajonale Tirane / OSSH sh.a, Rruga Reshit Petrela, perballe Dispanserise Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 30.04.2021

Ankesa: Nuk ka

**Drejtoria Rajonale Tiranë**